



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190429  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, më 1 nëntor 2016, mori këtë:

AKTVENDIM  
Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për organizimin dhe shënimin e manifestimit për nder të 28 Nëntorit.
2. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
  - 2.1. Kujtim Gashi- kryesues i KK, kryetar i Komisionit,
  - 2.2. Zeqir Xhaferi, nga DA,
  - 2.3. Urim Ukimeri, nga DKRS,
  - 2.4. Bashkim Lubovci, nga DEF,
  - 2.5. Sherife Qengaj, nga DTZHE
3. Detyrat e Komisionit do të jenë: të përgatit dhe zbatoj projektin për organizimin dhe shënimin e manifestimit për nder të 28 Nëntorit. Pas përfundimit të të gjitha organizimeve, të mbledh dhe verifikoj të gjitha shpenzimet e bëra dhe të njëjtat t'i procedoj për pagesë në organet kompetente.
4. Për mbulimin e shpenzimeve të krijuara gjatë shënimit të manifestimit për nder të 28 Nëntorit, lejohen mjetet e nevojshme financiare dhe se mjetet e lejuara do të paguhet pas parashtrimit të faturave përkatëse për këto shpenzime.
5. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 4 të këtij Aktvendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
6. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
7. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Komisionit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe të emëruarit.
8. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190432  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, më 1 nëntor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për participim (bashkëfinancim) në realizimin e projektit: “Konservimi dhe gërmime arkeologjike në kalanë e “Gralishtes” në Korishë”, i cili participim është i bazuar në memorandumun e bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Komunës së Prizrenit dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës, kështu që, për këtë qëllim, Komuna e Prizrenit lejon mjetet financiare në shumë prej 19.600 €, përkatësisht participon me 49% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e vlerës së projektit.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Komunës së Prizrenit dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni buxhetor i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik i planifikuar për këtë qëllim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Instituti i lartcekur, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190439  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, më 1 nëntor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për participim (bashkëfinancim) në realizimin e projektit: “Përfshirja Sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet RAE në Kosovë”, i cili participim është i bazuar në memorandumun e bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Komunës së Prizrenit dhe OJQ “VORAE”, kështu që, për këtë qëllim, Komuna e Prizrenit lejon mjetet financiare në shumë prej 15.000 €, e cila shumë do të ekzekutohet në faza.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Komunës së Prizrenit dhe OJQ “VORAE”.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni buxhetor i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i planifikuar për këtë qëllim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, OJQ-ja e lartcekur, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja







Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190450  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Turqisë dhe pagesës së mëditjeve për katër (4) zyrtarë të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës më 1 nëntor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Zehadin Shemsedini, drejtor i DKA, Myvedete Gavazaj, drejtoreshë e ShMLE “Ymer Prizreni”, Lumnije Rakaj, drejtoreshë e ShFMU “Abdyl Frashëri” dhe Liri Bajrami, drejtoreshë e ShFMU “Dy Dëshmorët”, për në Bursa të Republikës së Turqisë, me qëllim të pjesëmarrjes në takimet zyrtare me përfaqësuesit arsimor të këtij qyteti, lidhur me arritjen e partneritetit ne mes drejtorive përkatëse të Arsimit. Vizita (takimi) do të realizohet nga data 30 tetor 2016 deri me 3 nëntor 2016, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190456  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Maqedoni dhe pagesës së mëditjeve për tre (3) zyrtarë komunal, kryetari i Komunës më 1 nëntor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Levent Bush, nënkryetar i Kuvendit të Komunës, Sabina Dana-Birdaini, nënkryetare e Komunës dhe Ajradin Alija, shef i ZKK, për në Strugë të Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që organizohet nga OSBE e që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal ne promovimin e dialogut ndëretnik dhe forcimin e besimit mes komuniteteve. Punëtoria do të realizohet nga data 2 nëntor 2016 deri me 4 nëntor 2016, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190461  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me uniforma, kryetari i Komunës më 1 nëntor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e furnizimit me uniforma dimërore për stafin e kësaj drejtorie, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt realizohet prej kodit buxhetor-mallra dhe shërbime të kësaj Drejtorie.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja







Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-190471  
Më 1.11.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejin e shitjes së masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, kryetari i Komunës më 1 nëntor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejin tenderimit të masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e 20 m<sup>3</sup> dru të llojit ahu.
2. Shitja do të bëhet sipas specifikacionit të prezantuar të drejtorisë përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
4. Me këtë Vendimi të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

